

KODI I SJELLJES

ÇFARË NA KARAKTERIZON?

Vizioni ynë në Grupin OTE është ndërtimi i një bote më të mirë për të gjithë nëpërmjet teknologjisë dhe inovacionit.

Udhërrëfyesi ynë në përpjekjet tona për të arritur këtë objektiv në mënyrë të qëndrueshme është Kodi i Sjelljes i Grupit OTE, një paketë rregullash, implementimi i të cilave garanton operacione të suksesshme dhe një reputacion të mirë për kompaninë tonë, duke mbrojtur në të njëjtën kohë edhe grupet e interesit.

Kodi i Sjelljes reflekton angazhimin si të manaxhimit ashtu edhe të personelit të Grupit OTE për të punuar me integritet, përgjegjësi dhe transparencë në raport me klientët, furnitorët, punonjësit dhe aksionerët e tij. Është thelbi i Sistemit të Pajtuëshmërisë dhe Qeverisjes së Korporatës të adoptuar nga kompania.

Në Grupin OTE, sjellja etike, integriteti, meritokracia dhe lufta kundër korrupsionit është përgjegjësi te gjithëve ne. Duke adoptuar praktika të përgjegjshme të Qeverisjes së Korporatës dhe duke implementuar efektivisht Kodin e Sjelljes në çdo aspekt të biznesit tonë, ne i shtojmë vlerë Grupit tonë dhe nxitemi të përmirësojmë performancën tonë të përgjithshme.

Michael Tsamaz
Kryetar i Bordit Drejtues
të Telekom Albania

Aris Dimitriadis
Drejtor Ekzekutiv
për Pajtuëshmërinë, Sigurimin &
Manaxhimin e Riskut të Korporatës
në Grupin OTE

Çfarë e bën një kompani të suksesshme? Një produkt i mirë në vetvete nuk mund të ngjisë shkallët drejt suksesit dhe as nuk është i vetmi element që e bën klientin ta blejë atë. Në këtë vendim ndikon gjithashtu edhe reputacioni i kompanisë. Suksesi i një biznesi ka nevojë për dicka më shumë. Anëtarët e Bordit, drejtorët e përgjithshëm dhe manaxherët dhe punonjësit që punojnë për Grupin OTE - pjesë e Grupit Deutsche Telekom, duhet të sillen në përputhje me detyrimet ligjore, duke krijuar veti të tilla si besimi, kredibiliteti, siguria dhe reputacioni i mirë i Grupit.

Kjo diçka më shumë përfshin integritetin dhe përgjegjshmërinë personale të çdo punonjësi për veprimet e tyre. E thënë më konkretisht, të gjitha këto cilësi të marra së bashku përbëjnë kulturën e pajtuëshmërisë së kompanisë bazuar në vlera. Ky është një faktor që gjithashtu ndikon në suksesin e Grupit Deutsche Telekom. Suksesi i biznesit nuk qëndron mbi detyrimet ligjore dhe as nuk lidhet me moralin apo me integritetin. Mënyra sesi Grupi Deutsche Telekom e arrin suksesin është po aq e rëndësishme sa vetë suksesi, dhe Kodi i Sjelljes ofron një strukturë orientimi për këtë. Ai ndërthur dy aspekte thelbësore. Nga të gjithë punonjësit pritet që të përmbushin detyrimet ligjore dhe të sillen me ndershmëri. Për Grupin Deutsche Telekom, Kodi i Sjelljes është një kombinim midis kërkesave të brendshme dhe premtimit të

bërë botës jashtë grupit, në të njëjtën kohë. Gjithashtu, ai mundëson që Grupi OTE të mbetet një kompani transparente dhe një sipërmarrje e gjurmueshme nga të gjithë.

Kodi i Sjelljes zbatohet për të gjithë anëtarët e bordit, drejtorët e përgjithshëm, manaxherët dhe punonjësit e Grupit Deutsche Telekom në mbarë botën. Gjithashtu, ai zbatohet për të personat të cilët konsiderohen si të barabartë me punonjësit në terma funksionalë, p.sh. për punonjësit e përkohshëm të agjencive. Ai përmbledh vlerat e Grupit OTE dhe përkufizon llojin e sjelljes që kërkohet nga ata që punojnë për të. Sa herë që është e nevojshme, parimet bazë të Kodit të Sjelljes janë të specifikuara në detaje tek rregullat dhe politikat e brendshme. Kuptimi i vlerave kërkon që të gjithë punonjësit tanë dhe stafi manaxherial të tregojë respekt të ndërsjellë, mirënjohje dhe vlerësim në marrëdhëniet midis tyre. Gjatë implementimit të Kodit të Sjelljes çdo divizion i Grupit Deutsche Telekom duhet të respektojë detyrimet ligjore kombëtare dhe, për rrjedhojë edhe kulturën individuale të vendit ku ushtron aktivitetin.

Megjithatë, nuk do të ishte e mjaftueshme që Kodi i Sjelljes të konsiderohej thjesht si udhëzim i përgjithshëm. Ai duhet të jetë i mbushur me jetë dhe të promovohet në mënyrë sa më aktive nëpërmjet modeleve që duhet të ndiqen. Kryesisht janë drejtorët e përgjithshëm të Grupit Deutsche Telekom të cilët duhet të marrin përsipër këtë funksion të krijimit të modeleve për t'u ndjekur, jo vetëm duke treguar integritet, por duke vepruar në pajtim me ligjin dhe duke rrezatuar kredibilitet. Gjithashtu, ata duhet të sigurohen që punonjësit e tyre e njohin përmbajtjen e Kodit të Sjelljes dhe e kuptojnë sjelljen që kërkohet.

Kodi i Sjelljes dhe vlerat që ai përfaqëson nuk përfshijnë vetëm punonjësit e përhershëm të Grupit Deutsche Telekom. Kjo është arsyeja përse Grupi Deutsche Telekom pret që edhe konsulentët dhe furnitorët të veprojnë në pajtim me rregullat e sjelljes së këtij Kodi. Gjithashtu pret prej tyre ta sigurojnë që ata janë të detyruar të zbatojnë këto rregulla nëpërmjet kontrates.

Thomas Kremer
Anëtar Bordi, Përgjegjës për Mbrojtjen e
të Dhënave, Pajtueshmërinë dhe Çështjet
Ligjore

Manuela Mackert
Drejtoreshë për Pajtueshmërinë

Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, Grupi OTE ka përcaktuar përmbajtjen e Kodit të tij të Sjelljes si më poshtë:

+01 DREJTIMI I KORPORATËS

Grupi OTE pajtohet me të gjitha rregullat ligjore që udhëheqin manaxhimin dhe monitorimin e kompanisë si dhe respektimin dhe ruajtjen e standarteve të njohura ndërkombëtare të drejtimit të mirë dhe të përgjegjshëm të korporatës.

+02**MARRËDHËNIET E BIZNESIT**

Besimi dhe drejtësia në vendimet e biznesit janë elementë të domosdoshëm të marrëdhënieve të Grupit OTE me partnerët e tij të biznesit. Interesat private apo përfitimet personale të punonjësve nuk kanë asnjë ndikim në vendimet e biznesit.

2.1 KORRUPSIONI AKTIV

Për të ruajtur besimin e klienteve, bashkëpunëtorëve të biznesit, aksionerëve dhe publikut, Grupi OTE kundërshton me forcë dhe në çdo formë sjelljen korruptive dhe madje shmang edhe propozimin më të papërfillshëm për një sjellje të tillë. Më konkretisht, kjo do të thotë se punonjësit e Grupit OTE nuk mund t'ju ofrojnë, premtojnë përfitime zyrtarëve të vendit të tyre apo edhe atyre jashtë tij, as personave vendim-marrës që punojnë në sektorin privat brenda dhe jashtë vendit, për trajtim preferencial apo një vendim në favor të Grupit OTE. Punonjësit e Grupit OTE duhet ta kenë parasysh këtë kur përballen me dhurata apo ftesa për dreka pune dhe evente të lidhura me punën.

2.2 KORRUPSIONI PASIV

Punonjësit e Grupit OTE nuk duhet t'ja lejojnë vetes që t'u premtojnë apo ofrojnë dhurata dhe nuk duhet të pranojnë asnjë përfitim në qoftë se kjo u krijon ose mund t'u krijojë bindjen palëve dhuruese se ato mund të influencojnë në vendimet e punonjësve. Për më tepër, punonjësit e Grupit OTE kurrë nuk duhet të kërkojnë përfitimeve për veten e tyre apo edhe për palët e treta.

2.3 KONTRATAT E SHËRBIMIT PUBLIK

Tregu i shërbimeve publike është një treg shumë i rëndësishëm për Grupin OTE. Punonjësit e Grupit OTE veprojnë në përputhje me rregullat që ndalojnë ndikimin e panevojshëm në tenderat e sektorit publik dhe që sigurojnë një konkurrencë të ndershme.

2.4 KONTROLLI I TREGUT

Grupi OTE ka marrëdhënie ndërkombëtare biznesi. Si rrjedhojë, ai është i përfshirë në mënyrë aktive në tregun ndërkombëtar të produkteve dhe shërbimeve dhe është një mbështetës i tregëtisë së lirë. Në këtë kontekst, grupi OTE vepron në përputhje me rregulloret tregtare të zbatueshme përsa i përket embargove dhe kontrolleve të importit/eksportit.

2.5 PROKURIMI

Njësia e Prokurimit të Grupit OTE dhe palët e autorizuar janë përgjegjëse për prokurim të produkteve dhe shërbimeve në mënyrë profesionale dhe me kushte optimale në përfitim të Grupit OTE. Prokurimi vepron në përputhje me ligjet në fuqi të vendeve ku ai ushtron aktivitetin e tij, duke qenë se shmangia e prokurimit mund të çojë në disavantazhe për Grupin OTE. Prokurimit i është dhënë përgjegjësia për të gjitha veprimtaritë e blerjeve.

2.6 FURNITORËT

Grupi OTE mban marrëdhënie biznesi me furnitorët e tij, të cilat janë të bazuara tek besimi dhe ndershmëria. Në këmbim, Grupi OTE pret që edhe furnitorët e tyre ta trajtojnë atë me të njëjtin respekt dhe ndershmëri. Shpeshherë furnitorët janë edhe klientë. Grupi OTE refuzon të përfitojë padrejtësisht në situata të tilla dhe veçon në mënyrë rigorozë të gjitha aktivitetet e blerjeve nga ato të shitjeve. Çdo marrëveshje reciproke duhet të aprovohet nga departamenti përgjegjës i prokurimit.

2.7 KONKURRENCA

Grupi OTE dhe punonjësit e tij janë angazhuar të zhvillojnë konkurrencë të drejtë në të gjitha marrëdhëniet e biznesit. Ata garantojnë se nuk finalizojnë marrëveshje biznesi me konkurrentët, klientët apo furnitorët të cilët kufizojnë konkurrencën në çmime, duke ndarë produktet apo tregjet në mënyrë gjeografike. Kjo vlen sidomos për tenderat. Vendimet e biznesit merren në mënyrë të pavarur dhe pa shkëmbyer informacione të rëndësishme me konkurrentët. Grupi OTE as nuk shpërndan informacion të pasaktë për produktet dhe shërbimet e konkurrentëve dhe as kërkon të arrijë avantazhe në mënyrë të pandershme dhe abuzive.

2.8 RAPORTIM FINANCIAR TRANSPARENT

Bilanci i Grupit OTE përpilohet në përputhje me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe prezanton një pasqyrë të vërtetë e të qartë të aseteve, detyrimeve dhe të rezultateve të veprimtarisë dhe pozitës financiare.

2.9 DONACIONET

Si një pjesëtar i rëndësishëm i shoqërisë, Grupi OTE merr përsipër përgjegjësi sociale në ato vende ku ushtron aktivitetin. Grupi OTE vepron si mbështetes dhe kontribues në arsim, shkencë, kulturë, aktivitete që lidhen me përgjegjshmërinë sociale, sportet dhe për mbrojtjen e mjedisit në shumë aspekte, të gjitha

këto duke u bazuar në ligjet e veçanta të vendit dhe në politikat dhe rregullat e tij të brendshme, si dhe në varësi të mundësive të tij financiare. Ky kontribut merr forme nga partneritetet, donacionet monetare dhe jo-monetare dhe shërbimet. Grupi OTE nuk jep donacione për të përfituar avantazhe në treg. Grupi OTE nuk bën donacione në llogari personale apo private dhe as për individë dhe organizata që mund të dëmtojnë interesat apo imazhin e Grupit OTE.

2.10 KONTRIBUTET POLITIKE

Grupi OTE nuk jep donacione në para për partitë politike apo për zyrtarët e zgjedhur, dhe nuk u ofron atyre përfitime jo-monetare përtej asaj që është ligjërisht e lejueshme.

2.11 PASTRIMI I PARAVE

Grupi OTE merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aktivitetin e pastrimit të parave brenda sferës së tij të influencës.

2.12 SPONSORIZIMI

Sponsorizimi është një nga instrumentët e komunikimit të Grupit OTE. Aktivitetet që sponsorizohen janë të fokusuar në drejtim të sporteve, muzikës dhe aktiviteteve të lidhura me përgjegjshmërinë sociale. Të gjitha aktivitetet që sponsorizohen duhet të jenë në përputhje me sistemin ligjor të vendit ku ushtron aktivitetin dhe me politikat e brendshme të sponsorizimit. Të gjitha aktivitetet e sponsorizimit bëhen në mënyrë transparente dhe nëpërmjet një komunikimi të përshtatshëm dhe të verifikueshëm dhe shërbimeve të marketingut nga ana e partnerëve/organizatorëve të sponsorizimit.

+ 03

SHMANGIA E KONFLIKTEVE TË TJERA TË INTERESIT

Grupi OTE pret që interesat personale të anëtarëve të Bordit Drejtues, drejtorëve të përgjithshëm, manaxherëve dhe punonjësve të tij të mos bien ndesh me ato të grupit.

3.1 PUNËSIMI DYTËSOR

Punësimi dytësor nuk duhet të jetë në konflikt me interesat e Grupit OTE; kjo vlen në veçanti për punësimin dytësor tek konkurrentët.

3.2 PJESËMARRJA NË KAPITAL

Pjesëmarrja nga ana e punonjësve të Grupit OTE në kapitalin e konkurentëve apo partnerëve të biznesit të Grupit OTE, që u jep atyre influencë investitori mbi biznesin, nuk është në interesin e Grupit OTE.

+ 04

PËRDORIMI I PRONËS SË KOMPANISË PËR QËLLIME PERSONALE

Përdorimi për qëllime personale i pronës së kompanisë lejohet vetëm kur kjo përcaktohet në kontrata individuale, marrëveshje kolektive apo rregullore të kompanisë, ose kur një përdorim i tillë lejohet nga praktika e kompanisë.

+ 05

TRAJTIMI I INFORMACIONIT

5.1 SIGURIA E TË DHËNAVE

Siguria e të dhënave është një shqetësim i madh për Grupin OTE. Është një faktor vendimtar në suksesin dhe imazhin publik të grupit. Kjo është arsyeja pse Grupi OTE përdor të gjitha mjetet teknike dhe organizative në dispozicion të tij për të mbrojtur të dhënat e kompanisë, të klientëve, partnerëve të biznesit, bashkëpunëtorëve dhe punonjësve kundër aksesit të paautorizuar, përdorimit të paautorizuar dhe të gabuar, të humbjes dhe të shkatërrimit të parakohshëm. Ai vepron brenda kuadrit ligjor përkatës dhe ligjeve kombëtare si edhe në përputhje me rregulloret dhe politikat e tij të brendshme.

5.2 PRIVATËSIA E TË DHËNAVE

Grupi OTE është i vetëdijshëm se të dhënat personale të klientëve të tij, bashkëpunëtorëve të biznesit, aksionerëve dhe të punonjësve janë shumë të rëndësishme dhe i mbron këto të dhëna në mënyrë shumë të përgjegjshme dhe të kujdesshme. Për këtë arsye, Grupi OTE ndërmerret një sërë masash teknike dhe organizative për të ruajtur konfidencialitetin e këtyre të dhënave personale nëpërmjet këtyre përpjekjeve. Çdo individ është përgjegjës brenda qëllimit të detyrave të tij/saj për të siguruar një nivel të lartë privatësie të të dhënave. Punonjësit e Grupit OTE i përmbahen rreptësisht rregullave për ruajtjen e të dhënave dhe veçanërisht respektojnë të drejtat gjithëpërfshirëse të subjekteve, të dhënat e të cilëve mbledhin, përpunojnë dhe përdorin.

5.3 DETYRIM I PËRGJITHSHËM PËR KONFIDENCIALITETIN

Përveç masave teknike dhe organizative për ruajtjen e privatësisë së të dhënave, çdo punonjës i Grupit OTE është i detyruar të mbrojë interesat e biznesit të kompanisë. Për këtë arsye, çdo informacion që del nga kompania apo ndonjë informacion në lidhje me çështje të Grupit OTE duhet t'u komunikohet vetëm

marrësve të autorizuar, pavarësisht faktit nëse janë punonjës të Grupit OTE apo të palëve të treta. Gjithashtu, Grupi OTE e konsideron të rëndësishëm ruajtjen e informacionit dhe mbron dokumentat e biznesit kundrejt aksesit të paautorizuar.

5.4 INFORMACIONI I BRENDSHËM

Për të siguruar integritetin e tregut dhe për të rritur besimin e publikut në tregjet financiare, punonjësit e Grupit OTE u binden rregullave që ndalojnë përdorimin e informacionit të brendshëm, veçanërisht rregullat për konfidencialitetin, ndalimin e dhënies së rekomandimeve apo nxitjen e të tjerëve si dhe ndalimin e ujdive të brendshme.

+06

ZBATIMI I RREGULLAVE TË SJELLJES

Grupi OTE pret që anëtarët e Bordit Drejtues, drejtorët e përgjithshëm, manaxherët dhe punonjësit të sillen në përputhje me Kodin e Sjelles.

Çdo shkelje e këtyre rregullave, detyrimeve ligjore, apo rregulloreve dhe politikave të brendshme mund të ketë pasoja serioze jo vetëm për individët që i kryejnë ato, por edhe për Grupin OTE. Për rrjedhojë, sjellja e papërshtatshme nuk do të tolerohet.

Pa asnjë përjashtim, Grupi OTE do të ndalojë rreptësisht çdo sjellje të papërshtatshme apo shkelje të parashikimeve ligjore. Grupi OTE do të veprojë në këtë mënyrë pa marrë parasysh statusin e punonjësit apo pozicionin që ka brenda grupit.

Grupi OTE krijon një atmosferë dhe klimë të përjashtuar nga frika ndaj pasojave negative, në mënyrë që të inkurajojë punonjësit të raportojnë dhunën dhe sjelljen e papërshtatshme, nëse do të jetë e nevojshme.

ANEKS: PYETJE DHE SHËNIME

Eprorët direktë janë të parët në radhë kur bëhet fjalë për adresimin e pyetjeve lidhur me zbatimin e Kodit të Sjelljes në punën e përditshme të punonjësve. Për më shumë informacion është krijuar portali i këshillimit “Më Pyet!”, i cili ndihmon në qartësimin e pasigurive përsa i përket sjelljeve të caktuara në raport me pajtueshmërinë e tyre me Kodin e Sjelljes. Sjellja e papërshtatshme duhet të vihet në dukje për qëllime parandalimi dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse. Për këtë arsye është krijuar portali i sinjalizimit “Më Thuaj!”.

PORTALI “MË PYET!”

Pyetjet përse i përket pajtueshmërisë me Kodin e Sjelljes dhe politikave të brendshme mund t'i adresoni tek portali “Më Pyet!”.

Për “Më Pyet!” kontaktoni në:

E-Mail: complianceoffice@telekom.com.al

PORTALI I SINJALIZIMIT “MË THUAJ!”

Informacioni lidhur me shkeljet e mundshme të detyrimeve ligjore, apo të rregullave dhe politikave të brendshme, mund të sinjalizohen nëpërmjet portalit “Më Thuaj!”. Asnjë nga ata që kryejnë sinjalizime nuk do të kenë pasoja negative, me kusht që ata vetë të veprojnë në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. Këto sinjalizime duhet të bëhen në masën që sinjalizuesi ka dijeni dhe bindje për atë që ka konstatuar. Sidoqoftë, cilido që bën akuzime apo sinjalizime jo të kujdesshme, apo qëllimisht të rreme, apo të pabazuara, do të përballet me pasojat e këtij akti.

Parimisht, Grupi OTE i inkurajon punonjësit e tij të flasim direkt me eprorët e tyre. Në këtë mënyrë, shpesh është e mundur që problemet të zgjidhen plotësisht. Nëse e përjashtojmë këtë opsion, sinjalizimi i sjelljeve të papërshtatshme mund të bëhet me postë, telefon, ose e-mail. Gjithashtu, ekziston edhe mundësia e depozitimit të një raporti në portalin “Më Thuaj!” në mënyrë anonime përmes Formularit Elektronik të Pajtueshmërisë. Megjithatë, mënyra anonime duhet të përdoret në raste të veçanta, në rast se i druheni pasojave negative mbi ju, p.sh. në bazë të Kodit të Punës, apo pasojave të një natyre sociale.

Çdo informacion i dhënë do të trajtohet në konfidencialitet të plotë dhe do të kontrollohet për besueshmërinë e tij nga persona të trajnuar, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

Për “Më Thuaj!” kontaktoni në:

Adresa: Telekom Albania sh.a.
Internal Audit & Compliance Office,
Rruga Gjergj Legisi, Laprake, Tirana, Albania

Tel: +35542275321

E-mail: complianceoffice@telekom.com.al

Internet: https://www.telekom.com.al/whistleblowing_eng/

ANEKS: INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion mbi Kodin e Sjelljes, mund vizitoni faqen e Internetit të kompanisë.

Internet: <https://www.telekom.com.al/company/compliance/>

Informacion të dobishëm shtese mund të gjeni edhe më poshtë:

- Strategjia e kompanisë, që përshkruan synimet e kompanisë.
Internet: <https://www.telekom.com.al/company/who-we-are/>
- Parimet Udhëzuese të Grupit OTE, që udhëzojnë se si duhet të zbatohet në praktikë strategjia e kompanisë.
Internet: <https://www.telekom.com.al/company/who-we-are/>
- Statuti Social, nën të cilin Grupi OTE angazhohet, ndër të tjera, të respektojë dhe promovojë të drejtat e njeriut (duke përfshirë këtu standartet themelore të punës të ILO). Pajtueshmëria e Grupit OTE me Statutin Social analizohet nëpërmjet anketave një herë në vit tek të gjitha kompanitë e Grupit si pjesë e Raportit të Qëndrueshmërisë dhe Përgjegjësisë së Korporatës.
Internet: <https://www.telekom.com.al/company/csr-reports/>